



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 1129/prot.  
3

Tiranë më 11 . 11 .2020

REKOMANDIM

Nr. 25 , datë 11 . 11 .2020

PËR KONTROLLUESIN “*INTERMEDICA CENTER*” SHPK

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar (në vijim, “*Ligji*”), ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” (në vijim “*Kodi i Procedurave Administrative*”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “*Intermedica Center*” SHPK.

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 147, datë 22.09.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “*Komisioneri*”), u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “*Intermedica Center*” SHPK (në vijim, “*Kontrolluesi*”), me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi “*Intermedica Center*” SHPK.

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit, vëren se:

1. Kontrolluesi “*Intermedica Center*” SHPK (në vijim, “*Kontrolluesi*”) është një shoqëri e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj: “*Ushtrim të aktivitetit diagnostikues dhe kurues, kurim i sëmundjeve në kushte spitalore dhe ambulatorë, organizim të shërbimit të urgjencës, obstetrikë-gjinekologjik. Importimi aparaturave dhe pajisjeve elektro-mjekësore tregtimi me shumicë dhe pakicë. Marrje me qira ose ndërtime godinash. Vizita dhe konsulta të specialiteteve të ndryshme.*”

Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave punëmarrës, kandidatë për pozicionin e lirë të punës, pacientë dhe vizitorë. Të dhënat përpunohen manualisht dhe nëpërmjet instrumenteve elektronike.

2. Kontrolluesi nuk ka vendosur politika privatësie në faqen zyrtare, [www.intermedica.al](http://www.intermedica.al), në kuadër të detyrimit për informim, në zbatim të nenit 18 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6, datë 05.08.2012, të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” (në vijim, “Vendimi nr. 6”). Megjithatë Kontrolluesi disponon një dokument të shkruar për politikën e konfidencialitetit dhe përdorimin e cookies.

Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, si dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes së internetit, ka detyrimin të publikojë “Politikat e Privatësisë”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes së internetit. Në këtë kuadër, publikimi i “Politikave të Privatësisë” përmbush më së miri qëllimin e informimit.

3. Kontrolluesi informon subjektin e të dhënave (pacientët që paraqiten për të përfutur shërbim) për përpunimin e të dhënave të tyre personale nëpërmjet plotësimit të një “Deklaratë për përpunimin e të dhënave personale” pranë zyrave të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi nëpërmjet plotësimit të “Deklaratë për përpunimin e të dhënave personale” nuk është i plotë, pasi përmbajtja e tij nuk reflekton qëllimin e përpunimit të të dhënave personale, kategorinë e të dhënave që përpunohen, kategorinë e marrësve të të dhënave (përfshirë, palët të treta përpunuese), periudhën e ruajtjes, arsyen e përpunimit, si dhe të drejtën e ankimit pranë Zyrës së Komisionerit, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit, dispozitat e Udhëzimit nr. 49, datë 02.03.2020 “Për mbrojtjen e të dhënave personale shëndetësore” (në vijim, “Udhëzimi nr. 49”) dhe Vendimin nr. 6, datë 05.08.2012 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” (në vijim, “Vendimi nr. 6”).

4. Kontrolluesi ka hartuar “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, por në përmbajtjen e saj, rregullorja është hartuar në mënyrë të përgjithshme duke mos specifikuar dhe dokumentuar masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, nuk janë parashikuar afatet për ruajtjen e të dhënave personale, si dhe mënyra e shkatërrimit të tyre kur të ketë përfunduar qëllimi i grumbullimit të tyre, në referim të parimeve ligjore dhe rregullave specifike të parashikuara në udhëzimet e miratuara nga Zyra e Komisionerit në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një rregulloreje të posaçme për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh të të dhënave), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim

shumë i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

5. Për realizimin e kontratave "*Për përpunimin e të dhënave nga kompani të treta*", Kontrolluesi vë në dispozicion të palëve të treta (në vijim, "*Përpunuesit*") të dhënat personale dhe sensitive të pacienteve, nëpërmjet e-mail, me tabelë "*Excel*".

Sa më sipër, nuk rezulton në praktikë që Kontrolluesi të sigurohet që përpunuesi të marrë masa tekniko-organizative për të mbrojtur të dhënat personale nga çdo përpunim i paautorizuar duke përfshirë shkatërrimin, humbjen, përhapjen e paligjshme apo dëmtimin e tyre.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave shëndetësore, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave duke mbajtur parasysh dhe rregullat e përcaktuar në Udhëzimin nr. 49.

6. Gjithashtu, Kontrolluesi bën pjesë në kategorinë e subjekteve përpunuese të mëdhenj në kuptim të Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018, të Komisionerit "*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*" (në vijim, "*Udhëzimi nr. 47*").

Kontrolluesi nuk ka të dokumentuar marrjen e masave në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe vërehet mosplotësim i detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr. 47.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe ka paraqitur me shkrim pretendimet lidhur me konstatimet e procesverbalit të hetimit administrativ si vijon:

- Lidhur me plotësimin e "*Politikave të Privatësisë*" ato janë të pranishme në faqen zyrtare shoqëruar edhe me "*Politikat e vëzhgimit me kamera CCTV*";
- Lidhur me "*Deklaratën*" për përpunimin e të dhënave personale, Kontrolluesi pretendon ky dokument është në përputhje me Ligjin. Sa i përket pretendimit se "*Deklarata*" është në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 49, Kontrolluesi pretendon se qëllimi i përpunimit të të dhënave është lidhur me rezultatet

e analizave, ruajtjen e dosjes personale të secilit pacient dhe kontaktet lidhur me njoftime të analizave të tyre. Periudha e ruajtjes në sistemin LIAMIS i shërben pacientëve për krijimin e kartelës së tyre mjekësore.

- Lidhur me Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale Kontrolluesi pretendon se kjo rregullore është specifike dhe përmbush të gjitha kërkesat ligjore.
- Lidhur me shkatërrimin e të dhënave në përfundim të qëllimit të grumbullimit, Kontrolluesi shprehet se të dhënat e pacientëve nuk shkatërrohen por mbeten në sistem, ndërsa afatet e ruajtjes dhe shkatërrimi i dokumentacionit të kandidatëve për punë dhe punonjësve të larguar janë të parashikuar në Rregulloren përkatëse.
- Lidhur me konstatimin se Kontrolluesi nuk ka marrë masa për trajnimin e punonjësve që kanë akses në përpunimin e të dhënave personale dhe për ngritjen e sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit, Kontrolluesi shprehet se stafi i tij ka nënshkruar "*Deklaratën e Konfidencialitetit*" dhe është njohur me rregulloren e Laboratorit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe "*Kodin e Sjelljes dhe Etikës*", dokumentin për mbrojtjen e rrjetit dhe "*Politikat e Sigurisë së Informacionit*". Gjithashtu, kemi dorëzuar kopje të Trajnimit të Sistemit LIAMIS.

Lidhur me pretendimet dhe provat e paraqitura nga Kontrolluesi mbi konstatimet e evidentuara nga grupi i inspektimit në procesverbalin e hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit vlerëson se në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ është konstatuar mungesa e rubrikës informuese mbi "*Politikat e Privatësisë*", duke mos informuar subjektet e të dhënave, që vizitojnë këtë faqe. Kontrolluesi ka reaguar pas kontrollit duke i publikuar ato, por kujtojmë që ky detyrim i Ligjit duhet të ishte plotësuar nga Kontrolluesi që në momentin e krijimit të faqes.

Për sa i takon informimit të subjekteve nëpërmjet Deklaratës për përpunimin e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit vlerëson se dokumenti nuk është i plotë, pasi në përmbajtjen e tij mungojnë elemente të rëndësishme (si qëllimi i përpunimit të të dhënave personale, kategoritë e të dhënave që përpunohen, kategoritë e marrësve të të dhënave (përfshirë, palët të treta përpunuese), periudhën e ruajtjes, arsyen e përpunimit, si dhe të drejtën e ankimit pranë Zyrës së Komisionerit), të parashikuara në nenin 18 të Ligjit.

Lidhur me hartimin e "*Rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*", Zyra e Komisionerit konstaton se është hartuar në mënyrë të përgjithshme duke mos specifikuar dhe dokumentuar masat tekniko-organizative të përshtatura, nuk janë parashikuar afatet e për ruajtjen e të dhënave personale, si dhe mënyra e shkatërrimit të tyre kur të ketë përfunduar qëllimi i grumbullimit të tyre, në referim të parimeve ligjore dhe rregullave specifike të parashikuara në udhëzimet e miratuara nga Zyra e Komisionerit.

Lidhur me detyrimin e kontrolluesit për krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit dhe Sigurisë së Informacionit në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47, kujtojmë se ky sistem është specifik për mbrojtjen e të dhënave

personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit “Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre” (në vijim, “Udhëzimi nr. 48. Gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, përfaqësuesit e Kontrolluesit nuk kanë vendosur në dispozicion asnjë dokument apo certifikatë që të vërtetoj plotësimin e këtij detyrimi.

Si përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit administrativ dhe reagimin e tij për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe ndalon mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 27, 29, 30, 31 (pika 1, gërma “a/1”), si dhe 32 të Ligjit,

#### REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të hartojë një rregullore të posaçme, në të cilën të specifikohen dhe dokumentohen masat konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, ku të parashikohen afatet për ruajtjen e të dhënave personale, si dhe mënyra e shkatërrimit të tyre kur të ketë përfunduar qëllimi i grumbullimit të tyre, në përputhje me veprimtarinë dhe proceset përpunuese që kryen;
2. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e stafit të tij, si dhe sa i përket krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të krijohet në përputhje me standardin ISO/IEC 270001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, si dhe mund të certifikohet, për qëllime përputhshmërie me standardin në fjalë, nga organizma të akredituar dhe autorizuar në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi. Në këtë rast, Kontrolluesi, në përputhje me germën “b” të pikës 42 të Udhëzimit nr. 47, depoziton pranë Zyrës së Komisionerit një kopje të certifikatës së përputhshmërisë;

3. Kontrolluesi, me qëllim garantimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të çdo individ, veçanërisht, të drejtën për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 49, duke u siguruar që përpunuesi të marrë masa tekniko-organizative për të mbrojtur të dhënat personale nga çdo përpunim i paautorizuar duke përfshirë shkatërrimin, humbjen, përhapjen e paligjshme apo dëmtimin e tyre.

4. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32, të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
- (i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 1;
  - (ii) brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra.

5. Në rast mospërmbushjeje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot, më datë 11.11.2020

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

